



USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 51 (827698)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 25 Dhjetor 2020

Kursi i XVII-të "Komando"



Stërvitja komplekse 72 orëshe, testim i aftësive fizike dhe psikike

"Kursi "Komando" ka hyrë në fazën e tij më sfiduese. Trupat që aspirojnë të bëhen pjesë e një ndër strukturave elitë të Forcave të Armatosura, po zhvillojnë stërvitjen sflitëse, 72 orë pa ndërprerje, gjatë së cilës duhet të kalojnë prova ekstreme fizike dhe psikologjike. Në stërvitjen, që po zhvillohet në Bizë, trupat

po testojë aftësitë në marshimin në këmbë me të gjitha pajimet personale në distancat 25 km, alpinizëm, goditje objekti, luftim i afërt apo mbijetesë", shkruan ministria Xhaçka ne facebook. Ditën e enjte, 17 dhjetor 2020, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji i shoqëruar...

» faqe 4

Ish-ushtarakët në pension nuk janë më debitorë ndaj shtetit Falen "detyrimet" e ish-ushtarakëve në pension ndaj sigurimeve shoqërore

Xhaçka: Mbi 800 familje ushtarakësh përfitojnë 111 milionë lekë të reja të falura duke gjetur kështu drejtësinë e munguar

» faqe 3



Në ambientet e "Garnizonit Skënderbej"

Gradime për personelin e Akademisë së Forcave të Armatosura



» faqe 5

Zv/komandanti kolonel Ylli Pulaj

Bashkëpunimi me Forcat Ajrore Italiane do të konsolidohet më tej

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj priti në 17 dhjetor 2020, në një takim zyrtar atasheun ushtarak të Republikës së Italisë në vendin tonë, kolonel Nicola Piccolo. Kolonel Pulaj falenderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas dhe për mbështetjen e vazhdueshme që Republika e Italisë dhe Forcat e Armatosura Italiane kanë dhënë...



» faqe 4

Forca Detare

Gradohen 19 oficerë dhe 23 nënoficerë

Në ambientet e Komandës së Forcës Detare, u zhvillua ceremonia e gradimeve të personelit nënoficer, oficer të Forcës Detare. Personeli i graduar u përshëndet nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut të parë Ferdinand Kreshpani, i cili uroi dhe vlerësoi efektivat për arritjet dhe rezultatet e punës së tyre të vazhdueshme disa vjeçare. Ai shtoi më tej: "Unë shpresoj, që ky promovim juaji sot të pasohet nga të tjerë në vitet..."

» faqe 5



Ministri Mbrojtjes i Bullgarisë, Karakachanov

Jemi në bisedime për të blerë një ose dy nëndetëse

» faqe 13

PËRBËRJA, FUNKSIONI DHE DETYRAT

Komisioni Teknik Këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive

» faqe 2

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

Vazhdojnë regjistrimet për ushtarë/ detarë për periudhën 8 mars-14 maj 2021

» faqe 7

PËRBËRJA, FUNKSIONI DHE DETYRAT

Komisioni Teknik Këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive

Nën drejtimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet dhe funksionon Komisioni Teknik Këshillimor (në vijim KTK), i cili këshillon për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile

Këshilli i Ministrave ka miratuar në mbledhjen e datës 16 dhjetor 2020, vendimin për “Përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Teknik Këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive”. Kjo është bërë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave. Këshilli i Ministrave vendosi se nën drejtimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet dhe funksionon Komisioni Teknik Këshillimor (në vijim KTK), i cili këshillon për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile.

KTK-ja kryesohet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe ka në përbërje përfaqësues të ministrive, të strukturave në varësi të tyre dhe të institucioneve, si më poshtë: Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Brendshme; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Kulturës; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Drejtoria për Çështjet Vendore dhe Prefekturat; Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin; Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (me ftesë); Shërbimi Gjeologjik Shqiptar; Instituti i Shëndetit Publik; Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (me ftesë); Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore; Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH); Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha; Universiteti Politeknik i Tiranës (me ftesë); Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare; Agjencia e Kombëtare e Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Pyjeve; Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake; Instituti i Ndërtimit (me ftesë); Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG); Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha; Universiteti Bujqësor i Tiranës (me ftesë); Korporata Elektro-



energjitike Shqiptare (KESH); Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE); Enti Kombëtar i Banesave (me ftesë); Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (me ftesë). Niveli i përfaqësimit në KTK është drejtues, ose specialist, i cili, në ushtrimin e detyrës së tij, ka kompetenca për çështjet e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore të institucionit, apo të strukturës që përfaqëson.

Mënyra e funksionimit të Komisionit Teknik Këshillimor

KTK-ja thirret dhe drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sa herë që ai e gjykon të nevojshme, por jo më pak se një herë në gjashtë muaj. Në varësi të nevojave, në mbledhjet e KTK-së ftohen edhe përfaqësues nga institucione shkencore dhe monitoruese, organizatave joqeveritare etj; Drejtori i AKMC-së për çështje specifike, sipas rastit, mund të thër-

rasë një pjesë të anëtarëve të KTK-së; Pranë KTK-së funksionon sekretaria teknike, me punonjës të AKMC-së, e cila përgjigjet për përgatitjen e materialeve dhe për njoftimin për mbledhjen e radhës së komisionit, duke ia dërguar çdo anëtar, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes.

Komisioni Teknik Këshillimor ka përgjegjësi

Të shqyrtojë strategjitë, politikat, programet dhe planet për zvogëlimin e

riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit; të shqyrtojë dhe të rekomandojë për çështjet që lidhen me programet e edukimit/arsimimit për strukturat e sistemit të mbrojtjes civile dhe publikun e gjerë në fushën e mbrojtjes civile; të shqyrtojë dhe të analizojë planet për emergjencat civile, të përgatitura nga institucionet shtetërore e joshetërore, dhe të japë rekomandimet përkatëse, sipas rastit; të ndihmojë në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes civile, vënien në efikasitet të plotë të tij, përcaktimin e prioriteteve, si dhe identifikimin e nevojave; të kontribuojë në rrugët e zgjidhjes për masat parandaluese, të rehabilitimit dhe të rimëkëmbjes për lloje të ndryshme fatkeqësish natyrore, ose fatkeqësi të tjera; të shqyrtojë, ose të vlerësojë studime në fushën e mbrojtjes civile. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, institucionet e përmendura më sipër dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.



Ish-ushtarakët në pension nuk janë më debitorë ndaj shtetit

Falen “detyrimet” e ish-ushtarakëve në pension ndaj sigurimeve shoqërore

Xhaçka: Mbi 800 familje ushtarakësh përfitojnë 111 milionë lekë të reja të falura duke gjetur kështu drejtësinë e munguar

Më 17 dhjetor 2020, Parlamenti Shqiptar, i dha fund kalvarit të gjatë dhe absurd të ish-ushtarakëve në pension, të cilët për faj të shtetit u klasifikuan “debitor” ndaj, po vetë shtetit, konkretisht Sigurimeve Shoqërore. Kjo u bë e mundur me miratimin nga Parlamenti të Projektligjit “Për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi”,-siç u shpreh në fjalën saj para deputetëve në parlament, ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, se kjo “shënon mbylljen e një kalvari të stërzgatur, të një prej atyre historive tipike të tranzicionit, ku shteti krijonte situata tmerrësisht të koklavitura, që më pas binin mbi kurrrizin e njerëzve duke shkaktuar stres e lodhje e stërmundim për vite e vite me radhë”.

“Më në fund, tha Xhaçka, pas një kohe të gjatë mundimi, iniciativash gjysmake e sorollatje rrugëve të gjykatave, mbi 800 familje ish-ushtarakësh gjejnë drejtësinë e munguar. Ka qenë një situatë vërtet absurde, ku në njërin anë për faj të shtetit, ish-ushtarakët kanë marrë pensione suplementare, e në anën tjetër një vendim gjykate i detyronte këto pensione si një gabim, e i shpallte ish-ushtarakët në pension debitorë ndaj shtetit duke iu kërkuar të kthenin pagesat suplementare për vite e vite”.

“Imagjinoni pra, tha ajo, një grup pensionistësh dhe sidomos një grup si ish-ushtarakët, që kanë qenë në fakt ndër kategoritë që janë viktimizuar më shumë nga gjithë historia e tranzicionit, për të mos folur pastaj për përndjekjen me të cilën janë trajtuar ata nga qeveria paraardhëse, papritur u shpallën debitorë ndaj shtetit e duhet të kthenin miliona lekë mbrapsht.”

Me miratimin e këtij projektligji, qeveria shqiptare do të tërhiqet nga 874 procese gjyqësore të ndjekura pikërisht për shkak të një detyrimi absurd të imponuar nga Gjykata e Lartë vite më parë, e të mbështetur në një skemë sigurimi shoqëror suplementar të vitit 1996 të ndryshuar shtatë herë deri në ditën që po flasim”.

Në vazhdim, ministrja Xhaçka tha se: “nëpërmjet këtij projektligji, 800 familjeve të ish-ushtarakësh u falën rreth 111 milionë lekë të reja si detyrime ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke vënë në vend dinjitetin e një kategorie shumë të nderuar të shoqërisë shqiptare, siç janë ushtarakët. Ne kemi punuar shumë me shoqatat e ish-ushtarakëve për të gjetur një zgjidhje. Qeveria ka punuar shumë, sepse ky ka qenë një premtim që u kemi bërë ish-ushtarakëve. Por nuk ka qenë aspak e lehtë. Unë sot dua të falenderoj kryetarin e Kuvendit, z. Ruçi, i cili ishte nismëtar i këtij projektligji e që njëherësh ka qenë vazhdimisht një nga mbështetësit kryesorë të gjetjes së një zgjidhje për këtë problem. Mbështetja dhe angazhimi i tij personal sigurisht që ka qenë një ndihmë e madhe për të gjithë ne në adresimin e këtij problemi.

Me dakordësinë edhe të Minis-

trisë së Financave, historia e detyrimeve të ish-ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, e famshmja çështje e borxhit të pensioneve të ish-ushtarakëve, fatmirësisht merr sot një zgjidhje. Me këtë projektligj mbyllet njëherë e mirë kalvari, që në fakt ishte i tepërt, për të gjithë ata burra e gra, që i kanë shërbyer këtij vendi, kanë sakrifikuar për sigurinë e tij, por që deri më sot nuk u trajtuan siç

e meritonin.

Unë jam krenare, që arritëm t'i japim më në fund zgjidhje kësaj çështje, e cila nuk ishte thjesht financiare, por ishte po aq edhe një çështje dinjiteti njerëzor e respekti për këtë kategori. Dhe nëse hedh sytë prapa, besoj që ekziston sot një kontrast shumë i qartë në mënyrën sesi shteti shqiptar i trajton ushtarakët e ish-ushtarakët sot, me mënyrën sesi janë

trajtuar deri dje. Sepse duhet ta themi që ky nuk është vendimi i parë i kësaj natyre që merr kjo qeveri. Vetëm pak kohë më parë, ne miratuam së bashku vendimin për rikthimin e trajtimit financiar për ushtarakët, duke rritur ndjeshëm të ardhurat për familjet e afro 5 mijë ushtarakëve aktivë e duke dërguar kështu edhe një mesazh solidariteti e respekti për burrat e gratë në uniformë.

Miratimi i Projektligjit “Për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, vjen si një akt drejtësie sociale, si përm-bushje e një detyrimi të shtetit shqiptar ndaj ish-ushtarakëve, por edhe si një përm-bushje e një zotimi, që të gjithë ne kemi marrë vite më parë ndaj kësaj kategorie”.

VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Ministria e Mbrojtjes, pronat që kalojnë në përgjegjësi administrimi

Më datë 16 dhjetor 2020, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi, që në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, bashkëlidhur vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon: Shtohen pronat me numra rendorë nga 1 435 (një mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) deri në 1 446 (një mijë e katërqind e dyzet e gjashtë), sipas formularëve standard të inventarizimit dhe planrilevimeve bashkëlidhur. Lista përbëhet nga 13 (trembëdhjetë) fletë inventari dhe 12 (dymbëdhjetë) fletë planrilevimi, që janë pjesë përbërëse e këtij vendimi. Përmasat e disa pronave zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët standardë të inventarizimit dhe në planrilevimet bashkëlidhur këtij vendimi. Lista përbëhet nga 12 (dymbëdhjetë) fletë inventari dhe 8 (tetë) fletë plane rilevimi, që janë pjesë përbërëse të këtij vendimi. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.



Kursi i XVII-të “Komando”

Stërvitja komplekse 72 orëshe,
testim i aftësive fizike dhe psikike

Stërvitja u krye në poligonin kombëtar të Bizës dhe është një nga pjesët më të vështira të kursit “Komando”, marshim në këmbë, në distancën 25 kilometra me pajisje

“Kursi “Komando” ka hyrë në fazën e tij më sfiduese. Trupat që aspirojnë të bëhen pjesë e një ndër strukturave elitë të Forcave të Armatosura, po zhvillojnë stërvitjen sfilite, 72 orë pa ndërprerje, gjatë së cilës duhet të kalojnë sprova ekstreme fizike dhe psikologjike. Në stërvitjen, që po zhvillohet në Bizë, trupat po testojë aftësitë në marshimin në këmbë me të gjitha pajimet personale në distancat 25 km, alpinizëm, goditje objekti, luftim i afërt apo mbijetesë”, -shkruan ministria Xhaçka ne facebook.

Ditën e enjte, 17 dhjetor 2020, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji i shoqëruar nga komandanti i batalionit “Komando” kolonel Edmond Doda ka inspektuar nga afër kryerjen e stërvitjes komplekse 72 orëshe të kursit të XVII-të “Komando”. Kjo stërvitje u krye në poligonin kombëtar të Bizës dhe është një nga pjesët më të vështira të kursit Komando pasi ka në programin e saj marshim në këmbë me të gjitha pajimet personale në distancat 25 kilometra dhe sigurimin e ushqimit në natyrë (mbijetesa).

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji gjatë inspektimit nga afër të kësaj stërvitjeje përgëzoi efektivin e Instruktorëve për nivelin e lartë të përgjegjësisë dhe seriozitetit të kryerjes së këtij kursi si dhe falenderoi kursantët e kursit të XVII-të “Komando” për vendosmërinë dhe shpirtin e sakrificës, që ata po tregojnë. Çdo gjë është e mundur kur ka frymë grupi dhe një objektiv të qartë për tu arritur. Unë shpresoj, që periudha që ju po kaloni gjatë kësaj stërvitjeje, t’ju shërbejë për tu rritur edhe më tepër profesionalisht, për të treguar se kur punojmë së bashku çdo gjë është e mundur. Por, besoj gjithashtu që ju do



të vazhdoni të rriteni edhe më tepër nga ana profesionale, kur të përfundoni me sukses kursin “Komando” dhe të merrni beretën e kaltër”, - tha ai.

Stërvitja komplekse 72 orëshe e

kursit “Komando” ka për qëllim testimin e aftësive ekstreme fizike dhe psikike duke i bërë të aftë kursantët të përshtaten me mjedisin që i rrethon për të kryer me sukses çdo detyrë luftarake

që mund t’i ngarkohet. Gjatë kësaj stërvitjeje u kryhen këto tema: marrshim në këmbë, taktikat e njësive të vogla, alpinizëm, prita, goditje objekti, luftim i afërt, mbijetesë, traversa topografike.

E veçanta e kësaj stërvitjeje është se përveçse ngarkesës së madhe fizike dhe psikologjike janë zbatuar me sukses edhe të gjitha masat e rrepta mbrojtëse nga COVID-19.

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji gjatë inspektimit nga afër të kësaj stërvitjeje përgëzoi efektivin e Instruktorëve për nivelin e lartë të përgjegjësisë dhe seriozitetit të kryerjes së këtij kursi si dhe falenderoi kursantët e kursit të XVII-të “Komando” për vendosmërinë dhe shpirtin e sakrificës, që ata po tregojnë. Çdo gjë është e mundur kur ka frymë grupi dhe një objektiv të qartë për tu arritur.

ZËVENDËSKOMANDANTI I FORCËS AJRORE, KOLONEL YLLI PULAJ

Bashkëpunimi me Forcat Ajrore
Italiane do të konsolidohet më tej

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj priti në 17 dhjetor 2020, në një takim zyrtar atasheun ushtarak të Republikës së Italisë në vendin tonë, kolonel Nicola Piccolo. Kolonel Pulaj falenderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas dhe për mbështetjen e vazhdueshme që Republika e Italisë dhe Forcat e Armatosura Italiane kanë dhënë në rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve ushtarake të Forcës Ajrore. Në vijim, ai njohu atasheun me zhvillimet aktuale në Forcën Ajrore, duke shprehur vullnetin në vijimin e bashkëpunimit ushtarak kryesisht në zhvillimin e kapaciteteve e teknikës ajrore, por edhe në drejtim të kualifikimit të burimeve njerëzore.

Nga ana e tij, kolonel Piccolo, falenderoi kolonel Pulaj për pritjen e ngrohtë dhe theksoi se, bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë



dhe Forcën Ajrore do vijojë edhe në të ardhmen duke synuar rritjen më tej të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes, sidomos me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave Ajrore Italiane me qëllim mbështetjen dhe mundësimin e realizimit të aktiviteteve ushtarake dypalëshe duke përfshirë edhe implikimet që sjell situata e pandemisë COVID-19. Në për-

fundim, kolonel Pulaj shprehu bindjen se, bashkëpunimi ushtarak midis Forcës Ajrore Shqiptare dhe atyre Italiane do të konsolidohet më tej, si në kuadër të bashkëpunimit ushtarak dypalësh ashtu edhe në kuadër të NATO-s, si dhe falenderoi edhe një herë kolonel Piccolo për vizitën duke i uruar punë të mbarë e suksese në detyrën e atasheut ushtarak të Republikës së Italisë në vendin tonë.

Gjeneral brigade
Xhebexhia, priti atasheun
Italian kolonel Piccolo

Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, paradite priti në një vizitë kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Italisë kolonel Nicola Piccolo në vendin tonë. Mbasi i uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Detare, gjeneral brigade Xhebexhia theksoi marrëdhëniet e mira që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve dhe veçanërisht ndërmjet dy forcave detare, njëkohësisht e njohu ata me punën dhe përpjekjet që ka bërë efektivin e Forcës Detare për realizimin e misionit në det dhe përmbushjen e angazhimeve e standardeve të NATO-s. Nga ana e tij kolonel Piccolo, falenderoi komandantin e Forcës Detare për mikpritjen dhe shprehu gatishmërinë e tij personale dhe të Forcave të Armatosura të Italisë për të vazhduar dhe shtuar bashkëpunimin në çdo fushë, që të dy palët e shohin me interes të përbashkët.

Në ambientet e “Garnizonit Skënderbej”

Gradime për personelin e Akademisë së Forcave të Armatosura

Marrja e gradës së radhës është shpërblim i kontributit të dhënë në vijimësi në Forcat e Armatosura

Më 17 dhjetor 2020, në ambientet e “Garnizonit Skënderbej” u zhvillua ceremonia e dhënies së gradave për personelin e Akademisë së Forcave të Armatosura. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura Gjeneral brigade Albert Mullai, zv/komandanti kolonel Fatmir Neziraj dhe drejtorët e drejtorive.

Hapja e ceremonisë u bë me leximin e urdhrat të ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për dhënien e gradave personelit oficer dhe nënoficerë.

Në AFA morën gradën e radhës 19 vetë nga këto gjashtë femra. “Marrja e gradës së radhës nga ana juaj është shpërblim i kontributit që keni dhënë në vijimësi në Forcat e Armatosura. Profesionalizmi dhe përkushtimi i shprehur në përditshmërinë e punës aty ku shërbeni, shpresoj që të shërbej si motivim për brezat më të rinj në radhët e FA. Duke ju uruar për marrjen e gradës njëkohësisht dua t’ju shpreh urimet e mia për ju dhe familjet tuaja, gëzuar festat e fund vitit”, u shpreh gjeneral Mullai në fjalën e tij të përshëndetjes.

“Fundi i vitit shpërblen përkushtimin dhe profesionalizmin e më të mirëve në Forcat e Armatosura. Gra, vajza, burra e djem në të gjitha forcat dhe strukturat e FA bashkë me gradat e reja, morën mbi shpatulla edhe përgjegjësi më të mëdha”, shkruan ministria Xhaçka ne facebook.



Në ambientet e Komandës së Forcës Detare

Gradohen 19 oficerë dhe 23 nënoficerë

Në ambientet e Komandës së Forcës Detare, u zhvillua ceremonia e gradimeve të personelit nënoficer, oficer të Forcës Detare. Personeli i graduar u përshëndet nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut të parë Ferdinand Kreshpani, i cili uroi dhe vlerësoi efektivat për arritjet dhe rezultatet e punës së tyre të vazhdueshme disa vjeçare. Ai shtoi më tej: “Unë shpresoj, që ky promovim



juaji sot të pasohet nga të tjerë në vitet pasi karriera juaj do të vazhdojë. Forca Detare u është mirënjohëse për punën dhe shërbimin tuaj”. Ceremonia vijoi me leximin e urdhrat të ministrit të Mbrojtjes dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura mbi gradimet e reja dhe më pas në mënyrë simbolike u vendosën gradat personelit të sapo graduar. Në total në Forcën Detare, morën gradën e radhës 19 oficerë, 23 nënoficerë.

NË AMBIENTET E KOMANDËS MBËSHTETËSE (KM)

Gradohen 64 ushtarakë, midis tyre një kolonel dhe dy nënkolonelë

Pas leximit të urdhrave të gradimit nga Shefi i Personelit n/kolonel Hyqmet Hoxha, një pjesë të tyre u vendos grada nga Komandanti i KM, Zëvendës Komandanti, Shefi i Shtabit dhe Komandantët e N/repartëve të KM. Më 17 dhjetor 2020, në Komandën Mbështetëse (KM) u zhvillua një ceremoni modeste për gradimet, ku në rang Komande u graduan një kolonel, dy nënkolonelë, pesë majorë, tetë kapitenë dhe pesëdhjetë e gjashtë nënoficerë nga të cilët dyzet e tetë tetarë dhe nëntë rreshterë. Me këtë rast Komandanti i Komandës Mbështetëse (KM) gjeneral brigade Ndrichim Sallaku falenderoi personelin e graduar për punën dhe impenjimin e

tyre maksimal në detyrë për realizimin e misionit në mbështetje të Forcave të Armatosura. “Në këtë ditë të veçantë për ju ndihem i nderuar, pasi nga dy grada madhore, një i përket KM dhe mendoj se jeni prezantuar mirë. Kjo për shumë nga ju nënkupton luftën e përpjekjet e përditshme tuaja që ju kanë dalluar në realizimin e detyrave. Shpresoj që ky të jetë një motivim më i madh për ju dhe e theksoj këtë sidomos për brezin më të ri siç janë kapitenët pasi hapësirat për ta në FA janë më të mëdha për të siguruar atë që nuk është dhe aq e lehtë jashtë këtyre mureve”. Ceremonia u zhvillua nën respektimin e masave të rrepta të sigurisë.



Forca Ajrore

Me një ceremoni të thjeshtë, në ambientet e jashtme të Komandës së Forcës Ajrore u zhvillua më 22 dhjetor 2020, ceremonia e dorëzimit të gradave, medaljeve të karrierës dhe certifikatë mirënjohje, për efektivin e strukturave të Forcës Ajrore të Garnizonit Rinas.

Të pranishëm në aktivitet ishin zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj, shefi i Shtabit dhe drejtuesit e strukturave të Forcës Ajrore në Garnizonin e Rinasit si dhe të gjithë ushtarakët aktivë dhe në rezervë të cilët respektivisht marrin gradat e radhës, medaljet e karrierës si dhe certifikatë mirënjohje për personelin ushtarak aktiv dhe ato në rezervë i cili ka plotësuar vitet e shërbimit në FA sipas ligjit.

Kolonel Pulaj në fjalën e tij falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen duke e cilësuar këtë ceremoni të thjeshtë por kuptimplotë pasi së pari, vijoi ai, do t'i dorëzojmë gradat personelit ushtarak, të cilët me mund dhe djersë e kanë fituar këtë të drejtë që i jep Ligji dhe rregulloret në fuqi. Ai shprehu kënaqësinë që një numër i konsiderueshëm i personelit ushtarak të Forcës Ajrore është promovuar duke merituar gradën e radhës si dhe i uroi atyre suksese të mëtejshme në karrierë.

Në vijim të fjalës së tij përshëndetëse zëvendëskomandanti citoi se, krahas gradimeve, sot japim medaljet e karrierës dhe ato të mirënjohjes për personelin, i cili ka dhënë ditët më të bukura të tyre Forcës Ajrore duke i shprehur atyre mirënjohjen dhe falënderimet e përzemërta për punën e kontributin si dhe i inkurajoi ushtarakët aktivë për vijimin e punës me përkushtim e çuarjen përpara të Forcës Ajrore,

ndërsa për ushtarakët në rezervë uroi integrimin dhe kontributin me statusin e ri në jetën civile.

Kolonel Pulaj mbylli fjalën e tij me urimet më të përzemërta për ushtarakët e promovuar në gradën e radhës, për

personelin, i cili për shërbimin në Forcat e Armatosura meritoi medaljen e Karrierës si dhe certifikatë mirënjohje për personelin i cili ka dalë në rezervë sipas ligjit duke i falënderuar dhe uruar atyre shëndet, gëzime,

harmonie e suksese të mëtejshme në karrierë dhe në familjet e tyre.

Ceremonia vijoi me leximin e urdhrave të Ministrit të Mbrojtjes për dhënie grade dhe dorëzimin e gradave por edhe të medaljeve të

Kolonel Pulaj në fjalën e tij falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen duke e cilësuar këtë ceremoni të thjeshtë por kuptimplotë pasi së pari, vijoi ai, do t'i dorëzojmë gradat personelit ushtarak, të cilët me mund dhe djersë e kanë fituar këtë të drejtë që i jep Ligji dhe rregulloret në fuqi. Ai shprehu kënaqësinë që një numër i konsiderueshëm i personelit ushtarak të Forcës Ajrore është promovuar duke merituar gradën e radhës si dhe i uroi atyre suksese të mëtejshme në karrierë.



MISIONI "RESOLUTE SUPPORT MISSION" AFGANISTAN

SHBA: "Medalje e Shërbimit të Meritës", kontingjentit shqiptar në Kabul

“Ushtarakët tanë vijnë të spikasin kudo ku ata shërbejnë”, - kështu e nis postimin e saj ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, teksa njofton se kolonel Ardian Lulaj dhe kontingjentet tona në Kabul u nderuan nga SHBA-ja me “Medaljen e Shër-

bimit të Meritës”. Kjo medalje ka ardhur ne shenjë nderimi për aftësitë dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të treguar gjatë shërbimit në misionin e NATO-s, Resolute Support. Postimi i Xhaçkës: Ushtarakët tanë vijnë të spikasin kudo ku ata shërbejnë! Përfaqësuesi më i lartë ushtarak

shqiptar në Afganistan, kolonel Ardian Lulaj dhe kontingjentet tona në Kabul u nderuan nga SHBA-ja me “Medaljen e Shërbimit të Meritës”, për aftësitë dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të treguar gjatë shërbimit në misionin e NATO-s, Resolute Support.



Koalicioni "Sentinel" në Gjirin Persik dhe Ngushticën e Harmuzit



Gjeneral brigade Xhebexhia, takim online me kundëradmiral Wood

Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia zhvilloi një takim online me komandantin kundëradmiral Craig Wood. Gjatë takimit u diskutua mbi situatën aktuale në Gjirin Persik dhe Ngushticën e Harmuzit. Komandanti i Koalicionit "Sentinel" informoi komandantin e Forcës Detare mbi operacionin e kësaj task-force në muajt e fundit. Gjeneral brigade Xhebexhia nga ana e tij informoi komandantin e Sentinel mbi statusin e personelit të Forcës Detare që do t'i bashkohet task-force. Komandanti i FD e siguroi komandantin e Sentinel mbi mbështetjen e plotë që ka task-forca nga Shqipëria.

PROJEKTI TEMATIK "TO BE READY"

Menaxher komunikimi: Ja tre renditjet përfundimtare

Në kuadrin e Projektit Tematik "TO BE READY"- "The flood and Big fire forecast and emergency management-355", me bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020", Ministria e Mbrojtjes ftoi kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës si vijon:

Menaxher Komunikimi për zbatimin e Projektit Tematik "TO BE READY"- "The flood and Big fire forecast and emergency management-355", bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA

CBC Itali- Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020".

Në shpalljen e pozicionit vakant, nga data 24.9.2020 deri më datë 26.10.2020 dorëzuan dokumentacionin përkatës 4 aplikantë për këtë pozicion pune. Sipas njoftimit të datës 14 dhjetor 2020, në testimin me shkrim të zhvilluar më datën 9.12.2020 dhe intervistën e strukturuar me gojë të zhvilluar më datën 11.12.2020, si dhe nga pikët e dosjes personale rezultoi kjo renditje përfundimtare: Floriana Mexhit Hima 84 pikë, Odeta Spero Thomaj 70 pikë dhe Elona Enver Hasanaj 62 pikë.



Qendra e Personel Rekrutimit

Vazhdojnë regjistrimet për ushtarë/detarë për periudhën 8 mars-14 maj 2021

Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri më 07 janar 2021

Qendra e Personel Rekrutimit vazhdon regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 08.03-14.05.2021, gjithsej 300 kandidatë, sipas rajoneve: Tiranë 145, Shkodër 20, Lezhë 4, Durrës 17, Vlorë 23, Berat 45, Elbasan 15, Burrel 7, Kukës 5, Fier 3, Gjirokastrë 3, Korçë 1, Poliçan 12 dhe sipas specialiteteve: Ndërlidhje 16, Këmbësori 104, MZ 5, Shofer 39, Mirëmbajtje 8, Kuzhinier 3, Xhenio 2, Infermieri 7, Roje 108, Muzikant 2, Përgjegjës kuverte 4, Municione. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri më 07 janar 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve

Të jetë shtetas shqiptar. Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në ndjekje penale. Të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata. Të ketë figurë të pastër morale. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos ketë probleme me drogën dhe alkoolin. Të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme, apo kriminale. Mosha minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtarë/detarë aktiv nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përfundim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç. Të ketë kryer arsimin parauniversitar, apo të lartë brenda, ose jashtë vendit. Të kenë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit. Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtarë/detarë aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak. Të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

Procedura e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv

Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtarë/detarë aktiv, do të aplikojnë



drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit. b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit, pranimit dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, kuotat e rekrutimit, specialitetet, rajonet e rekrutimit, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimin e përzgjedhjes, etj.

Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në QPR

Kandidatët për ushtarë/detarë aktiv paraqesin në Qendrën e Personel Rekrutimit, dokumentet e mëposhtme:

Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët në fazën e regjistrimit është: Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtruhet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtarë/detarë aktiv, si dhe jo më pak se dy mundësi

zgjedhje për njësinë, apo repartin në të cilin do të dëshiron të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, (formulari i aplikimit). Fotokopjen e kartës së identitetit. Certifikatë familjare, 1 copë, e cila gjenerohet online nga QPR-ja në bashkëpunim me DMBNJ&SH, në portalin e-albania, sipas akteve ligjore në fuqi. Dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm. Fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar të noterizuar dhe certifikatën e maturës shtetërore të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore rajonale/rrethit, e noterizuar, ose të arsimit të lartë të noterizuar. Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), për drejtim automjeti, për njohje të gjuhës angleze, të noterizuara. Raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes në qendrën shëndetësore të vendbanimit, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje infektive dhe të shëndetit mendor në anamnezën

e tij personale të jetës. Ekzaminimet mjekësore për agentët infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. Në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit, kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv, si dhe formularët e vetëdeklarimit.

Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit: Nëse kandidati shpallet fitues, brenda 2 (dy) javëve duhet të sjellë në QPR edhe dokumentacionin e mëposhtëm: Dëshmi penalteti. Vërtetim nga prokuroria. Vërtetim nga gjykata. Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjekoligjor (KML) i Njësinë Mjekësore Ushtarake.

Qendra e Personel Rekrutimit, në bashkëpunim me strukturat që kanë

Profesionet janë:
Ndërlidhje 16,
këmbësori 104,
MZ 5, shofer 39,
mirëmbajtje 8,
kuzhinier 3,
xhenio 2,
infermieri
7, roje 108, muzi-
kant 2, përgjegjës
kuverte 4,
dhe municione
2 kandidatë

akses në portalin e-albania, të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarkohet online nëpërmjet portalit qeveritar e-albania, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar vetëm në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarkohet nëpërmjet portalit.

Shënim:

Secili aplikant duhet të shkruajë me shkrim dore me rreth 100 fjalë, përse dëshiron të shërbejë në Forcat e Armatosura, çfarë dini për Forcat e Armatosura, për Forcën, brigadën, repartin ku doni të shërbeni dhe për specialitetin që keni zgjedhur. Secili aplikant duhet të deklarojë në përgjegjësinë e tij personale se informacioni, që ka shkruar në tërë dokumentacionin dhe formularët e aplikimit janë të vërteta, të saktë dhe janë dhënë me vullnetin e tij të lirë. Ai duhet të deklarojë se është i hapur ndaj autoriteteve kompetente për të bërë verifikimin e nevojshëm.

Mesazhi i fund vitit nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, në mbydhje të këtij viti, me anë të një video mesazhi, ka përshëndetur trupat e NATO-s. “Viti 2020 ka qenë sfiduese për të gjithë. Koronavirusi na ka prekur të gjithëve, familjet tona, shokët tanë”, thotë Jens Stoltenberg, në fillim të mesazhit. “Ka ndikuar në mënyrën se si jetojmë, mënyrën se si punojmë dhe madje edhe mënyrën e festimit të festave tona”, pohon ai. “Në këtë vit të vështirë, ju-burra dhe gratë tona me uniformë edhe një herë keni rritur nivelin e duhur. Kontributet tuaja të transportit, spitalet ushtarake në terren dhe mbështetjen mjekësore, kanë qenë thelbësore për të ndihmuar në luftën kundër virusit dhe për të shpëtuar jetë”, shkruan në mesazh Stoltenberg. Stoltenberg, pohon se: “përveç kësaj mbështetje për përpjekjet civile në luftimin e pandemisë, ju keni vazhduar të ofroni siguri për gati një miliard njerëz të NATO-s, me parandalim dhe mbrojtje të fortë, në tokë, në det, në ajër dhe në hapësirën kibernetike, duke na mbajtur të gjithë të sigurt. Kështu që unë dua të falënderoj të gjithë ju, kudo që të jeni, në Afganistan, Kosovë, Irak dhe në një nga operacionet tona detare, ose misionet e policimit ajror, si pjesë e pranisë së NATO-s në Lindjen e Aleancës, Struktura e Komandës së NATO-s ose këtu në Selinë e NATO-s. Shërbimi juaj do të thotë kaq shumë për mua dhe për njerëzit dhe vendet ku ju shërbeni”. “Unë jam përgjithmonë mirënjohës për sakrificat që ju dhe familjet tuaja bëni, për të na mbajtur të sigurt në shtëpi

Stoltenberg: NATO ofron siguri për gati një miliard njerëz

NATO ofroni siguri për gati një miliard njerëz, me parandalim dhe mbrojtje të fortë, në tokë, në det, në ajër dhe në hapësirën kibernetike



dhe e fortë si një Aleancë. Së bashku, ne jemi duke përgatitur NATO-n për të ardhmen, për të siguruar që ne mund të vazhdojmë të mbrojmë të gjithë aleatët kundër çdo kërcënimi. Për këtë, ne duhet ta mbajmë të fortë NATO-n. Fil-

lon me forca të forta ushtarake. Fillon me ju. Ju uroj juve dhe familjeve tuaja të gjitha të mirat për sezonin e festave! Qëndroni të sigurt dhe qëndroni të shëndetshëm!”, perfundon mesazhin e tij Jens Stoltenberg.

Pema e Krishtlindjes pranë Yllit të NATO-s dhe flamujve Aleatë

Tre pemë të Krishtlindjeve po sjellin gëzim festash në Selinë e NATO-s këtë vit. Në përputhje me masat e përgjigjes në fuqi, ndaj COVID-19, shumica e festimeve të fundvitit në NATO janë anuluar, ndërsa të tjerët, të tilla si Pazari i Bamirësisë vjetore i NATO-s, janë zhvendosur në internet. Por akoma ka qëndruar tradita e pemës së Krishtlindjes. Dy halorë më të vegjël artificialë të ripërdorshëm hijeshojnë Qendrën e Konferencave, ku mbledhet Këshilli i Atlantikut të Veriut, dhe zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s. Një pemë e madhe e Krishtlindjes është instaluar jashtë Shtabit, pranë Yllit të NATO-s dhe flamujve aleatë. Me një peshë rreth 1 ton dhe e lartë 12m, pema e Krishtlindjeve, Nordmann Fir, është afërsisht 25 vjeç. Ashtu si në vitet e mëparshme, ajo erdhi me rrugë nga një çerdhe në Ardenes belge dhe sigurohet nga “La Ferme nos Pilijs”, një projekt social që promovon bujqësi të qëndrueshme dhe punëson njerëz me aftësi të kufizuara. Staf i tyre dorëzoi dhe instaloi pemën e Krishtlindjes të NATO-s dhe do ta marrë atë në fillim të janarit. Pemët e Krishtlindjeve të NATO-s u instaluan në fund të nëntorit. U desh një ditë e plotë për t'i dekoruar ato, duke përdorur të njëjtat zbukurime si në vitet e mëparshme, në blu dhe argjend. Siç ka bërë për disa vite tani, një top i kuq u vendos në mënyrë “misterioze” në pemën në Qendrën e Konferencave - që i atribuohet magjisë së Krishtlindjes dhe “jo rrezikut të sigurisë”. Pas pushimeve, pema kryesore e Krishtlindjes e NATO-s do të riciklohet dhe copat e drurit do të përdoren si ilaç kundër barërave të këqija.

COVID-19 përgjatë vitit 2020: NATO ndihmoi aleatët dhe partnerët

Gjatë vitit 2020, personeli ushtarak i NATO-s dhe aleatëve ka ndihmuar në shpëtimin e jetës duke mbështetur përpjekjet civile kundër COVID-19, si në vendet aleate ashtu edhe në vendet partnere. Në gjysmën e parë të këtij viti, rreth 350 fluturime dhanë furnizime kritike në të gjithë botën. Në vendet e Aleancës, pothuajse gjysmë milioni trupa mbështetën përgjigjen civile, duke ndërtuar gati 100 spitale në terren, duke siguruar kufijtë dhe duke ndihmuar në testimin dhe transportin.

NATO zhvilloi një plan të ri operacionesh për të siguruar që aleatët të mbeten të gatshëm për të ndihmuar njeri tjetrin dhe partnerët. Aleanca krijoi gjithashtu një fond besimi për blerjen e artikujve të nevojshëm urgjentisht dhe një rezervë të furnizimeve mjekësore. Gjashtëmbëdhjetë aleatë kanë dhënë kontribute financiare gjithsej 5 milion euro dhe 5 kombe kanë dhënë kontribute në natyrë për rezervat. Gjatë gjithë vjeshtës, Shqipëria, Republika Çeke, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut morën dhjetëra ventilatorë dhe një total prej rreth 1.5 milion euro në pajisje mjekësore nga rezervat. Disa kontribute financiare janë duke u përdorur për t'u dhënë ndihmë partnerëve më të goditur të NATO-s, duke përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, Irakun, Republikën e Moldavisë, Tunizinë dhe Ukrainën.

Duke folur në Konferencën e Rigës



në nëntor, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg tha se “Aleatët e NATO-s dhe ushtarakët tanë kanë mbështetur njëri-tjetrin dhe partnerët tanë gjatë gjithë kësaj pandemie- duke transportuar pajisje mjekësore kritike, pacientë dhe ekspertë; vendosje të spitaleve ushtarake në terren dhe sigurimi i kufijve; mbështetjen e përpjekjeve civile dhe ndihmën për të shpëtuar jetë. Në të njëjtën kohë, ne qëndrojmë vigjilentë

dhe të gatshëm, sepse përgjegjësia kryesore e NATO-s është të sigurohet që kjo krizë shëndetësore të mos bëhet një krizë sigurie”.

Që nga fillimi i krizës, Qendra Koordinuese Euro-Atlantike e Reagimit të Fatkeqësive në NATO (EADRCC) ka koordinuar 22 kërkesa për ndihmë nga NATO dhe vendet partnere, si dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare.

Mbështetja logjistike e siguruar nga Agjencia e Prokurimit dhe Mbështetjes së NATO-s (NSPA) ka ndihmuar aleatët dhe partnerët të arrijnë blerjen e materialit lehtësues COVID-19, të shkallës ekonomike.

NSPA gjithashtu ka ndihmuar aleatët dhe partnerët në transportimin e artikujve urgjentë të ndihmave në vendet duke përdorur zgjidhje shumëkombëshe, të tilla si aftësia strategjike e

ngritjes së ajrit (SAC) dhe programet strategjike ndërkombëtare të zgjidhjes së ajrit (SALIS), si dhe përmes fluturimeve tregtare me qira të ofruara nga Luksemburgu. Në total, rreth 1,500 ton pajisje mjekësore dhe pajisje u transportuan në vendet aleate, duke përfshirë Hungarinë, Rumaninë, Bullgarinë dhe Hollandën, si dhe Republikën Çeke, Sllovakinë, Gjermaninë dhe Poloninë. NATO dhe aleatët gjithashtu kanë ndihmuar autoritetet lokale në vendet ku është vendosur, përfshirë Afganistanin, Kosovën dhe Irakun.

NATO gjithashtu ka punuar duke punuar ngushtë me organizata të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë Bashkimin Evropian, Organizatën Botërore të Shëndetësisë, Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare dhe Programin Botëror të Ushqimit të Kombeve të Bashkuara. Në korrik, në përgjigje të një kërkesë globale nga Kombet e Bashkuara për mbështetjen e transportit ajror në përgjigje të pandemisë COVID-19, fluturimet në Mbretërinë e Bashkuar, të koordinuara nga Qendra e Koordinimit Euro-Atlantike e Fatkeqësisë së NATO-s, transportoi një spital fushor nga Evropa në Akra, Ganë. Objekti përdoret për punonjësit e ndihmës në vijën e frontit në rajon për të ndihmuar në luftën kundër pandemisë së koronavirusit dhe ka kapacitetin për t'u kujdesur për deri në 92 persona.

Letrave të Bardha të NATO-s

Përgatiti: MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sic është përmendur edhe në artikujt e tjerë të serisë mbi inovacionin në NATO, Aleanca përballlet me një garë globale të adoptimit të teknologjisë. Fuqitë rivale po përdorin teknologji të reja për të ndjekur qëllimin e dyfishtë të konkurrencës më të madhe ekonomike së bashku me aftësitë më të mëdha ushtarake. Aleatët përballen me një sërë sfidash ndërsa kërkojnë të shfrytëzojnë teknologjitë në zhvillim dhe përçarës.

Edward Hunter Christie, zv/shef i Njësisë së Inovacionit, i Divizionit të Sfidave në Siguri, që është autor i Letrave të Bardha të NATO-s mbi Inteligjencën Artificiale dhe mbi Teknologjitë Autonome, paraqet përpjekjet aktuale për të zhvilluar politikën e Inteligjencës Artificiale në NATO. Ai thotë se këto sfida bazohen në dy shtylla të ndërlidhura të punës: sigurimi i një adoptimi dinamik të teknologjive të reja dhe qeverisja e tyre me përgjegjësi. Inteligjenca Artificiale (AI) është në zemër të këtyre konsideratave, nënvizon Christie.

AI është aftësia e makinerive për të kryer detyra që zakonisht kërkojnë inteligjencë njerëzore-për shembull, njohja e modeleve, të mësuarit nga përvoja, nxjerrja e konkluzioneve, bërja e parashikimeve ose marrja e masave-qoftë dixhital ose si softuer i mençur prapa sistemeve fizike autonome.

Sic është propozuar nga studiotori RAND në raportin Departamenti i Qëndrimit të Mbrojtjes për Inteligjencën Artificiale: Vlerësimi dhe Rekomandimet (2019), është e dobishme të bëhet dallimi midis tre llojeve të gjera të aplikacioneve: AI e Ndërmarrjes, AI e Mbështetjes së Misionit dhe AI Operative.

Inteligjenca Artificiale i ndërmarrjes përfshin aplikime të tilla si sistemet e menaxhimit financiar ose të personelit të mundësuar nga Inteligjenca Artificiale (të cilat vendosen në mjedise të kontrolluara fort, ku implikimet e dështimeve teknike janë të ulëta (për sa i përket rrezikut të menjëhershëm dhe vdekshmërisë së mundshme).Përkundrazi, Inteligjenca Artificiale operative mund të vendoset në misione dhe operacione, d.m.th. në mjedise mjaft më pak të kontrolluara dhe të tilla që implikimet e dështimit mund të jenë kritikisht të larta. Shembujt përfshijnë softuerin e kontrollit të sistemeve të palëvizshme ose ato të automjeteve pa pilot. Inteligjenca Artificiale e Mbështetjes të Misionit, një kategori e ndërmjetme për sa i përket kontrollit të mjedisit dhe implikimeve të dështimit, përfshin një grup të larmishëm aplikimesh, p.sh. logjistikë dhe mirëmbajtje, ose aplikacione të lidhura me inteligjencën.

Këto dallime mund të rezultojnë të dobishme në përcaktimin e përparësive, si për politikën e adoptimit, ashtu edhe për parimet e përdorimit të përgjegjshëm, duke marrë parasysh nivelet e ndryshme të rrezikut të natyreshmë për këto kategori.

Vala bashkëkohore e AI, ose AI e Valës së Dytë, përqendrohet te Mësimi Makinerive (ML). ML përfshin zhvillimin dhe përdorimin e algoritmeve statistikore për të gjetur modele në të dhëna. Për shembull, një algoritëm klasifikimi mund të trajnohet në një grup të madh shembujsh të etiketuar saktë për të përcaktuar se cilës kategori

të hasur më parë i përket një objekt i vëzhguar rishitazi. Mësimi i Thelluar është një nëngrup i ML, i cili përdor shtresa të shumëfishta llogaritëse (Rrjete Neurale Artificiale me shumë shtresa) për trajtimin e problemeve të njohjes ose parashikimit të modelit që kërkon llogari, p.sh. Rrjetet Neurale Konvucionare për zbulimin e objekteve brenda imazheve.

ML zhvillohet në grupe të mëdha të të dhënave të sakta dhe performon dobët me grupe të vogla të të dhënave ose me të dhëna të pasakta. Nën kushte të mira në një gamë të gjerë përdorimesh, ML i kalon më shumë njerëzit, sa i përket performancës parashikuese dhe natyrisht të shpejtësisë, mbi një gamë të rritje të detyrave të njohjes së modelit

kryesor.

A janë të dhënat atëherë ‘karburant’ i ri? Në thelb jo. Ndërsa të dhënat duhet të ‘nxirren’ dhe më pas të ‘rafinojnë’ para përdorimit të mëtejshëm, disponueshmëria e tyre rritet me vëllimin e prodhimit. Të dhënat janë gjithashtu specifike, jo të leverdishme. Për çdo rast specifik të përdorimit, grupe të dhënash specifike që kapin vëzhgime (ose simulime) reale të jetës reale janë të nevojshme. Për të siguruar një pikë fillestare solide, institucionet e mbrojtjes aleate do të duhet të sigurojnë dixhitalizimin e tyre të mëtejshëm. Në përgjithësi, politika e të dhënave duhet të adresojë një zinxhir të plotë të vlerës, duke mbuluar mbledhjen, aksesin, ndar-


epokave, aktorët ekonomikë kanë kërkuar mënyrat më të mira për të kombinuar faktorët e prodhimit: A janë ata plotësues? A janë ato të zëvendësueshme? Cilat kombinime sjellin kthimet më të larta? Cilat procese dhe praktika prodhuese dhe menaxheriale japin rezultatet më të mira? Për AI, ndërsa shkëmbimet ekzistojnë në një farë mase, faktorët e prodhimit janë shumë më të plotësueshëm sesa zëvendësuesit: duhen investime thelbësore në të tre faktorët për të pasur sukses.

